



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.86..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 16 / 06 / 2025

VENDIM

Nr.19, datë 16 /06 /2025

PËR

**MIRATIMIN E RREGJISTRIT TE DIGAVE SIPAS PERCAKTIMIT TE PIKES C, NENI 3
TE LIGJIT NR. 8681,DT02.11.2000, ME RREZIKSHMERI PER TE TRETE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 3, pika C, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 16.06.2025 mori në shqyrtim rregjistrin e digave që plotësojnë kërkesat e pikës C të mësipërme me rrezikshmëri për të tretë të cilat duhet të jenë objekt i punës së KKDM. Ky rregjister është përgatitur nga KTPD dhe ITD në bazë të listës zyrtare të digave të ujitjes të dërguara nga MBZHR dhe ka patur paraysh jo vetëm lartësinë e saj apo volumin e rezervuarit të krijuar por edhe shkallen e rrezikshmërisë që ato paraqesin për të tretët në rast të prishjes së digës apo vlerat ekonomike të tyre.

Kritere themelore për hartimin e këtij rregjistri kanë qenë shkalla e rrezikshmërisë që ato paraqesin për të tretët në rast prishje si dhe vlerat ekonomike të dëmeve që mund të shkaktojnë. Ky rregjister është bazuar në listën e digave dhe rezervuareve të përgatitur nga MBZHR gjatë procesit të kalimit të infrastrukturës ujore dhe aseteve të paluajtshme të kësaj infrastrukture sipas kërkesave të VKM Nr.1108, datë 30.12.2015. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Rregjistrin e Digave sipas listës bashkëlidhur dhe sipas kërkesave dhe përcaktimit të pikës C të nenit 3 të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 për vitin 2025 që do të jenë objekt i veprimtarisë së KKDM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- 2- SKDM të publikoj në faqen e internetit të KKDM këtë rregjister dhe t'ju kërkoj të gjithë shfrytëzuesve të këtyre digave të dërgojnë informacionin e duhur për gjëndjen e tyre si dhe të dhënat teknike kryesore të këtyre digave sic janë lartësia dhe gjatësia e tyre, volumi dhe sipërfaqja e rezervuarit të krijuar prej tyre, njerëzit që banojnë poshtë tyre dhe janë në rrezik, sipërfaqe e tokave që mund të përmytet nga prishja e mundshme e tyre si dhe të përgatitë arkivën e pasaportave të këtyre digave të përcaktuara në këtë rregjister sipas udhëzimit të KKDM të miratuar me vendimin Nr. 02, datë 21.09.2020 brenda vitit 2025.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe ndjekjen e detyrave të dhëna në këtë vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

